



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 tetor 2019
Nr.re.:RK 1450/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI95/19

Parashtrues

Ruzhdi Bejta

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. 54/2019, të 11 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ruzhdi Bejta, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 54/2019] e 11 marsit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 qershor 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 9 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 10 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa formularë të komisionit për intervistim, si dhe disa parashtrësia me të cilat parashtruesi i ishte drejtuar Gjykatës Themelore.
9. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 tetor 2012, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prishtinës kishte shpallur konkurs për plotësimin e vendeve të punës për drejtor dhe zëvendësdrejtor në

disa shkolla fillore dhe të mesme, ndër to edhe për shkollën e mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” në Prishtinë.

11. Parashtruesi i kërkesës kishte konkurruar për drejtor të shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli”.
12. Më 8 nëntor 2012, kryetari i Komunës së Prishtinës përmes Vendimit [Nr. ref. 020-40894] caktoi Komisionin intervistues. Ky i fundit kishte ftuar pesë kandidatë për intervistë. Nga këta pesë kandidatë, Komisioni intervistues kishte përpiluar listën e ngushtë me tre emrat e kandidatëve të cilët kishin grumbulluar më së shumti pikë. Në këtë listë të ngushtë të kandidatëve nuk ishte përfshirë kandidatura e parashtruesit të kërkesës. Lista në fjalë i ishte dërguar Komunës së Prishtinës me rekomandim që procedura e përzgjedhjes së drejtorit të finalizohet me vendim të kryetarit të Komunës së Prishtinës. Me vendim të këtij të fundit, drejtor i shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” ishte përzgjedhur kandidati i parë në listë me më së shumti pikë, respektivisht I. R.
13. Më 25 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin për përzgjedhjen e I. R. si drejtor, kishte parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave pranë Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejme: Komisioni i ankesave i MASHT-it).
14. Më 18 mars 2013, Komisioni i ankesave i MASHT-it e kishte shpallur vetën jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës ngase, sipas tyre, punësimi i personelit mësimdhënës dhe zgjedhja e drejtorëve të shkollave, është kompetencë e komunave.
15. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke kërkuar nga kjo e fundit që të anulojë Vendimin e Komunës së Prishtinës për zgjedhjen e kandidatit I. R. për drejtor, dhe të detyrojë Komunën e Prishtinës që nga radha e kandidatëve të paraqitur të bëjë zgjedhjen e kandidatit për drejtor. Ai po ashtu kishte kërkuar edhe kompensimin e pagave të porealizuara për pozitën e drejtorit. Parashtruesi i kërkesës e kishte arsyetuar kërkesëpadinë e tij me faktin se, sipas pretendimit në kërkesëpadi, në pozitën në fjalë ishte zgjedhur personi i cili nuk kishte qenë i kualifikuar për pjesën finale të garës për drejtor. Parashtruesi i kërkesës kishte konsideruar se ai do duhej të ishte fitues i konkursit në fjalë dhe jo personi i cili veçse është zgjedhur në atë pozitë.
16. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 1388/14], e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Si arsye për refuzim të kërkesëpadisë Gjykata Themelore, ndër të tjera, kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës e ka bazuar kërkesëpadinë e tij “në supozime dhe në pohime të pabazuara në fakte” dhe duke qenë se sipas nenit 7 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) “*palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat kontestohen faktet e tilla [...]*”, - kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte e pathemeltë. Në këtë aspekt, Gjykata Themelore theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar prova

që e mbështesin themelësinë e kërkesëpadisë së tij, ndërkaq e paditura, respektivisht Komuna e Prishtinës, kishte argumentuar se përzgjedhja e kandidatit të caktuar për drejtor është bërë në bazë të një procesi të rregullt. Bazuar në gjendjen e tillë faktike, Gjykata Themelore vlerësoi se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës duhej refuzuar si e pabazuar.

17. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale dhe asaj procedurale si dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
18. Më 10 shtator 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AC. nr. 2904/15], e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 1388/14] e 8 dhjetorit 2014 të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e arsyetoi pabazueshmërinë e ankesës nisur nga fakti se, sipas saj, Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit në mënyrë të drejtë dhe pa shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Më tutje, u konsiderua se Gjykata Themelore kishte administruar provat dhe faktet në mënyrë të drejtë dhe në tërësi si dhe kishte zbatuar të drejtën materiale në mënyrë korrekte.
19. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 11 mars 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 54/2019] e hodhi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion, me arsyetimin se pretendimet në revizion lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk ekzistojnë. Gjykata Supreme theksoi se sipas nenit 222 të LPK-së revizioni është i pabazuar.
21. Më saktësisht, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte theksuar si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Paditësi në procedurën e gjykatës së shkallës së parë, nuk ka ofruar prova, me të cilat do të kishte provuar besueshmërinë e pretendimeve lidhur me shkelje të ligjit material dhe procedural me rastin e mos përzgjedhjes së tij. Për mosveprim të paditësit në kuptim të dispozitës së nenit 319.1 të LPK-së, nuk mund t'i vishet përgjegjësia gjykatës si lëshim i saj.

Parashtrimet në revizion lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore që i referohen falsifikimit të procesverbalit të komisionit për intervistimin e kandidatëve, kjo gjykatë i vlerësoi si të papranueshme pasi paditësi nuk ka paraqitur fakte mbi të cilat mbështet pohimet e veta dhe nuk ka propozuar prova me të cilat i vërteton këto fakte”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën e tij për revizion si të pabazuar, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 23, 24, dhe 31 të Kushtetutës dhe të drejtën e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së.
23. Sipas parashtruesit të kërkesës dispozitat e neneve të cekura më lart “paraqesin garanci kushtetuese për mbrojtje të dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë dhe janë vlera themelore të një shoqërie demokratike e mbështetur në sundimin e së drejtës”.
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë si në vijim:

“[...] kërkojë nga Gjykata Kushtetuese të evidentojë shkeljet e cekura në aktgjykimet paraprake dhe të aprovojë kërkesën time, sepse konsideroj se gjykatat më të larta në vend lidhur me këtë çështje kanë nxjerrë vendime në kundërshtim me të drejtën”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113 i Kushtetutës
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili parasheh:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

28. Fillimisht, për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 54/2019] e 11 marsit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e parapara me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.
29. Megjithatë, Gjykata duhet gjithashtu t'i referohet edhe kriterëve tjerë relevante të pranueshmërisë të përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore të punës, respektivisht, nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 48 i Ligjit
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj”.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se neni 48 i Ligjit pasqyrohet dhe konkretizohet më tutje nga rregulli 39 (1) (d) i Rregullores së punës dhe si të tilla – këto dy rregullime – duhet të lexohen bashkërisht. (Shih, për parim të përgjithshëm të aplikimit të këtyre dispozitave, Aktvendimin për papranueshmëri K102/18, parashtues *Qeveria e Republikës së Kosovës* [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor], Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36).
31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit përmban gjithsej dy kërkesa. E para konsiston në (i) obligimin e parashtuesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë

cenuar nga autoriteti publik – vendimin e të cilit e kontestojnë; dhe, e dyta konsiston në (ii) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të specifikojnë aktin konkret të autoritetit publik që dëshirojnë ta kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese. Që të dy këto kritere të nenit 48 të Ligjit e veçanërisht kriteri i parë i këtij neni reflektohet edhe në rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës ku kërkohet që një kërkesë e parashtruar në Gjykatë duhet të qartësojë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

32. Sa i përket këtyre kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj dhe më tej të specifikuara në Rregullore të punës, Gjykata thekson se përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës ka specifikuar qartë se e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 54/2019] e 11 marsit 2019 të Gjykatës Supreme, si dhe faktit që ka përmendur dispozitat që pretendon se i janë shkelur, respektivisht nenet 23, 24, dhe 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, ai nuk e ka përmbyshur detyrimin e tij që *“në mënyrë adekuate të paraqet [...] pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese”* nga autoriteti publik, përkatësisht Gjykata Supreme në rastin konkret. Parashtruesi i kërkesës nuk është lëshuar në asnjë arsyetim të pretendimeve të tij. Ai thjesht ka përmendur nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së duke mos shpjeguar në asnjë mënyrë se si janë shkelur ato të drejta të parapara me këto nene, nga Gjykata Supreme apo gjykatat e tjera të rregullta që kanë vendosur për kërkesëpadinë e tij.
33. Në dritë të këtyre fakteve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që të qartësojë saktësisht pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe për rrjedhojë ka dështuar të përmbysh kërkesat e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KIO2/18, cituar më lart, paragrafët 40-41).
34. Edhe në nivel të GJEDNJ-së, rastet kur parashtruesit e kërkesës përmendin vetëm nenet e KEDNJ-së mirëpo nuk qartësojnë dhe nuk saktësojnë pretendimet e tyre, kërkesat e tilla shpallen si të papranueshme për mungesë të arsytimit mbi pretendimet për shkelje të KEDNJ-së. Kërkesa për të paraqitur përmbledhjen e fakteve dhe të shkeljeve të pretenduara të KEDNJ-së me argumentim përkatës kërkohet me rregullin 47 [Përmbajtja e Kërkesës Individuale] të Rregullores së punës së GJEDNJ-së i cili buron nga neni 35 [Kushtet e pranueshmërisë] të KEDNJ-së. Mosrespektimi i kërkesave të parapara nga këto dispozita rregulluese bën që kërkesat të mos merren në shqyrtim në merita nga GJEDNJ (shih në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së në të cilat parashtruesit nuk kanë arsyetuar fare pretendimet e tyre për shkelje të KEDNJ: *Yekaterina Afanasyevna Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 4241/03, Vendim i 31 majit 2005; dhe, *Michel Baillard kundër Francës*, kërkesa nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008).
35. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk saktëson qartë dhe nuk paraqet në mënyrë adekuate pretendimet për shkelje të të drejtave të tij dhe si e tillë kërkesa duhet të refuzohet për mosplotësimin e kritereve të

pranueshmërisë të parapara me nenin 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

36. Si rrjedhojë, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës, më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi